



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 739 Akti

Nr. 753 Vendimi  
Tiranë, më 3.4.2024

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	Kryesues
<b>Suela Zhegu</b>	Relatore
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 3.4.2024, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Laureta Nezaj (Çausi)**, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Laureta Nezaj (Çaushti), me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2021, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Olsi Komici kryesues dhe Brunilda Bekteshi anëtare. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 25.6.2021 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisioneri Olsi Komici. Në respektim të legjisllacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatorja e çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Francesco Ciardi.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar se:
  - *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
  - *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
  - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*

<sup>1</sup> Raporti i dërguar nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2018.

- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>2</sup>, duke konkluduar mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Laureta Nezaj.
7. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>3</sup> mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes në datën 20.3.2024, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Laureta Nezaj (Çaushi) dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
10. Për një proces të rregullt ligjor, znj. Laureta Nezaj i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; (iii) për përfundimin e hetimit administrativ kryesisht, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.
11. Znj. Laureta Nezaj (Çaushi), pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datën 29.3.2024. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara për hetimin e kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 29.3.2024.

---

<sup>2</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, i AKSIK-së, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.5.2023, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 25.4.2023, i KLGJ-së.

13. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 3.4.2024, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.
14. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

15. Subjekti i rivlerësimit Laureta Nezaj ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Znj. Laureta Nezaj ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
19. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.
21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;

- b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
- f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGj-ja;
- g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Laureta Nezaj, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

23. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, si dhe mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.

24. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga znj. Laureta Nezaj në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, e dorëzuar në ILDKPKI më 30.1.2017, në zbatim të ligjit, ku subjekti ka deklaruar:

#### **25. Kursime *cash*<sup>4</sup> nga paga vjetore (vitet 2014 – 2016) në shumën 1.300.000 lekë**

25.1 Subjekti i rivlerësimit Laureta Nezaj është emëruar ndihmëse ligjore në qershor 2013, duke u bërë subjekt deklarues nga viti 2013 e në vijim.

25.2 Nga verifikimi i deklarimeve periodike për periudhën 2014 – 2016, subjekti ka deklaruar:

- i) në DPV-në e vitit 2014, kursim nga paga vjetore në shumën 700.000 lekë;
- ii) në DPV-në e vitit 2015, kursim nga paga vjetore në shumën 700.000 lekë;
- iii) në DPV-në e vitit 2016, nuk deklarohen kursime cash.

#### **Lidhur me burimin e krijimit të gjendjes *cash***

25.3 Si burim për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 1.300.000 lekë, subjekti ka deklaruar të ardhura nga pagat vjetore për periudhën 2014 – 2016.

25.4 Nga informacioni i ardhur nga ISSH-ja<sup>5</sup> konfirmohen të ardhurat nga paga e subjektit pranë Gjykatës së Lartë për periudhën nga qershori 2013 e në vijim. Gjithashtu, në dosje është administruar vërtetimi përkatës mbi të ardhurat e pagës së subjektit si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, për periudhën 3.6.2013 – 31.12.2016.

#### **Analiza financiare**

<sup>4</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2017 të lëshuar nga Gjykata e Lartë, e cila konfirmon të ardhurat nga paga e subjektit për periudhën 3.6.2013 – 31.12.2016.

<sup>5</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2023.

25.5 Komisioni ka analizuar mundësitë financiare të subjektit për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 1.300.000 lekë, gjatë periudhës 2014 – 2016.

25.6 Referuar të dhënave të gjendjes civile<sup>6</sup>, si dhe certifikatave familjare<sup>7</sup> të administruara në dosje, ka rezultuar se subjekti ka qenë në një përbërje familjare me prindërit, motrën dhe vëllezërit deri në datën 23.3.2017 (kur është veçuar nga trangu familjar) dhe, më pas, në datën 6.5.2021, ka lidhur martesë ligjore me shtetasin A.Ç. Gjithashtu, gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar<sup>8</sup> se nga marrja e detyrës në qershor 2013 deri në maj 2021 ka jetuar me prindërit, vëllezërit dhe motrën, ku shpenzimet e jetesës kanë qenë të përbashkëta.

25.7 Nisur nga fakti se gjatë periudhës së krijimit të kursimeve *cash* subjekti ka qenë në një certifikatë familjare me prindërit dhe vëllezërit, ka jetuar me ta dhe shpenzimet kanë qenë të përbashkëta, Komisioni ka analizuar mundësitë financiare për krijimin e kursimeve *cash*, duke konsideruar të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin dhe familjarët e saj.

25.8 Shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së, si dhe shpenzimet e udhëtimeve nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS. Në analizë është pasqyruar edhe një shumë e paguar nga subjekti në favor të sigurimeve shoqërore për një sigurim vullnetar për periudhën 2005 – 2008. Gjendjet *cash* janë pasqyruar sipas deklarimeve në DPV-të periodike, si dhe gjendjet e llogarive, sipas *statement*-it bankar.

### **Konstatim i Komisionit**

25.9 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi për krijimin e kursimeve *cash*, duke rezultuar me balancë negative në shumën 1.202.317 lekë.

✓ Në lidhje me këtë balancë negative, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

25.10 Subjekti ka paraqitur prapësimet e saj lidhur me mundësitë e krijimit të kursimeve *cash* për vitet 2014 dhe 2015, të cilat nga analiza e Komisionit kanë rezultuar me balancë negative. Subjekti ka pretenduar se për vitin 2014 i janë llogaritur shpenzime udhëtimi në shumën 9.107 lekë, ndërkohë që vlera e shpenzuar prej saj në atë udhëtim ka qenë 40 euro, e konvertuar në 5.060 lekë (40 x 140 vlera e euros në atë datë) dhe për vitin 2015 i janë llogaritur shpenzime udhëtimi për nënën, motrën dhe vëllain e saj në shumën 118.284 lekë, ndërkohë që vlera e shpenzuar në atë udhëtim ka qenë 0 (zero), pasi shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit në atë rast janë mbuluar nga daja S.P, sipas ftesës së mirëpritjes së datës 30.1.2015, të lëshuar prej tij në gjuhën shqipe dhe frënge, për t'u paraqitur pranë autoriteteve në pikat kufitare, si dhe deklaratës së lëshuar prej tij në datën 27.3.2024.

25.11 Në mbështetje të shpjegimeve të saj, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues:

- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 27.3.2024, mbi të ardhurat e motrës S.N, ku për vitin 2014 paga neto është 408.524 lekë dhe për vitin 2015 paga neto është 502.570 lekë.

<sup>6</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.5.2023, e Ministrisë së Brendshme.

<sup>7</sup> Certifikatat familjare të lëshuara në datat 23.3.2017 dhe 23.9.2021 nga zyra e gjendjes civile e Njësisë Bashkiake Nr. \*, Tiranë; certifikatë martesë (nga akti) datë 23.9.2021 (dokumentacion i depozituar nga subjekti në pyetësorin standard).

<sup>8</sup> Në përgjigjet e pyetësorit standard.

- Kopje të mandatpagesave<sup>9</sup> të lëshuara nga Posta Shqiptare, ku të ardhurat nga pensioni i babait A.N për vitin 2014 janë në vlerën 178.986 lekë dhe për vitin 2015 janë në vlerën 183.736 lekë.
- Librezë pune nr. \*\*\*, në emër të nënës V.A.P, të shoqëruar me vërtetim për vjetërsi në punë, si dhe vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 1.12.1992 – 1.12.1993.
- Deklaratë datë 27.3.2024, e nënshkruar (me shkrim dore) nga shtetasi S.P, i cili deklaron se në datën 30.1.2015 u ka bërë një ftesë motrës së tij V.N dhe dy fëmijëve të saj S dhe M.N, për të kaluar disa ditë së bashku me familjen e tij në qytetin ku banon prej 20 vitesh. Në këtë ftesë i ka dhënë motrës së tij edhe garancinë se do të paguante të gjitha shpenzimet, si udhëtimin, akomodimin dhe çdo shpenzim që mund të lindte nevoja. Bashkëlidhur deklaratës ndodhet një letër “ftesë mirëpritjeje” datë 30.1.2015, e panënshkruar, ku në përmbajtje të saj, ndër të tjera, thuhet se shtetasi S.P me nënshtetësi franceze dhe banim në Francë mirëpret znj. V.N, vajzën S.N dhe djalin M.N për një periudhë 2-javore, 9.2.2015 – 24.2.2015.

25.12 Subjekti pretendon se duke shtuar vlerën e pensionit të prindërve dhe parashtrimet për shpenzimet e udhëtimit, analiza financiare do të rezultonte për vitin 2014 me balancë negative në shumën 30.809 lekë dhe për vitin 2015 me balancë negative në shumën 343.514 lekë.

25.13 Lidhur me mundësitë për kursim, subjekti ka parashtruar se nuk ka qenë e vetmja që ka kontribuar me pagën e saj për mbajtjen e familjes dhe përballimin e shpenzimeve familjare, ku për vitin 2014, të katërt pjesëtarët e familjes, prindërit, motra dhe subjekti, kanë qenë me të ardhura të ligjshme dhe, në vitin 2015, edhe vëllai. Subjekti ka shpjeguar se vëllezërit kanë punuar si kamerierë të pasiguruar dhe gjatë gjithë periudhës kanë qenë të gjithë me të ardhura, ku secili ka kontribuar me pjesën e vet për shpenzimet e jetesës. Subjekti ka prapësuar se ka dorëzuar personalisht një kuotë të caktuar dhe jo të gjithë pagesën, duke realizuar kursimet përkatëse.

### **Vlerësimi i Komisionit**

25.14 Komisioni, bazuar në shpjegimet e subjektit dhe në provat e depozituara në prapësime, reflektoi në analizë të ardhurat e ligjshme nga pensionet e prindërve, të dokumentuara për periudhën 2014 – 2016, ndërsa çmon të mos i konsiderojë pretendimet e subjektit lidhur me uljen e shpenzimeve të udhëtimeve, të cilat janë të paprovuara me dokumentacion të rregullt ligjor. Nga përlllogaritjet e kryera nga Komisioni, pas rishikimit të analizës financiare, ka rezultuar një balancë totale negative në shumën 541.908 lekë për vitet 2014 dhe 2015 (siç është pasqyruar në tabelën e përgjithshme në vijim).

---

<sup>9</sup> Mandatpagesë datë 20.1.2014 për shumën 14.814 lekë; mandatpagesë datë 19.2.2014 për shumën 14.814 lekë; mandatpagesë datë 19.3.2014 për shumën 14.814 lekë; mandatpagesë datë 22.4.2014 për shumën 14.814 lekë; mandatpagesë datë 19.5.2014 për shumën 14.814 lekë; mandatpagesë datë 19.6.2014 për shumën 14.814 lekë; mandatpagesë datë 18.7.2014 për shumën 14.814 lekë; mandatpagesë datë 19.8.2014 për shumën 15.054 lekë; mandatpagesë datë 19.9.2014 për shumën 15.054 lekë; mandatpagesë datë 20.10.2014 për shumën 15.054 lekë; mandatpagesë datë 19.11.2014 për shumën 15.054 lekë; mandatpagesë datë 19.12.2014 për shumën 15.054 lekë; mandatpagesë datë 19.1.2015 për shumën 18.054 lekë; mandatpagesë datë 19.2.2015 për shumën 15.702 lekë; mandatpagesë datë 19.3.2015 për shumën 15.702 lekë; mandatpagesë datë 20.4.2015 për shumën 15.702 lekë; mandatpagesë datë 19.5.2015 për shumën 15.702 lekë; mandatpagesë datë 19.6.2015 për shumën 15.702 lekë; mandatpagesë datë 29.7.2015 për shumën 14.414 lekë; mandatpagesë datë 18.9.2015 për shumën 14.586 lekë.

Trupi gjykues çmon se kjo balancë negative nuk përbën shkak të mjaftueshëm për aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**26. Apartament në përdorim, në pronësi të prindërve, në Tiranë.** Pjesa takuese: 0%.

26.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se banon së bashku me prindërit e saj në apartamentin në pronësi të tyre, të ndodhur në rrugën “K.G”, Tiranë.

26.2 Komisioni verifikoi lidhur me origjinën e krijimit të kësaj pasurie, ku nga dokumentacioni i pronësisë, i ardhur nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Tiranë Veri<sup>10</sup>, konfirmohet apartamenti me sip. 116.61 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*\*, zk. \*\*\*, i regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve A dhe V.N.

26.3 Nga aktet në dosje rezulton se ky apartament është blerë nga babai i subjektit A.N përmes kontratës së sipërmarrjes datë 5.10.2000<sup>11</sup> të lidhur me shoqërinë sipërmarrëse “S - M” sh.p.k., në vlerën 37.800 USD (300 USD/m<sup>2</sup>) dhe, më pas, është nënshkruar kontrata e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2013, për blerjen e apartamentit në vlerën 4.044.000 lekë. Kjo pasuri është regjistruar në pronësi të prindërve A dhe V.N, të cilët janë pajisur me certifikatë pronësie në datën 15.4.2013.

26.4 Nga verifikimi i deklarimeve periodike nga viti 2013 (para fillimit të detyrës) deri në vitin 2016, subjekti ka deklaruar si vendbanim adresën e apartamentit në pronësi të prindërve.

**26.5 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se:**

- Subjekti ka deklaruar saktë apartamentin në përdorim, pasuri e cila është blerë nga prindërit në vitin 2000, periudhë para emërimit të subjektit në detyrën e ndihmëses ligjore (qershor 2013).
- Për këtë pasuri nuk ngrihen dyshime për pasuri të fshehur të subjektit, pasi në kohën kur prindërit e kanë blerë, subjekti ishte studente dhe nuk mund të kishte kontribut në krijimin e saj.

**DEKLARIMI I PASURISË NGA BABAI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**27. Apartament<sup>12</sup> me sip. 116.61 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën “K.G”, Tiranë, pasuri në bashkëpronësi me bashkëshorten në vlerën 4.044.000 lekë.**

**Hetimi i kryer nga Komisioni**

27.1 Lidhur me këtë pasuri u kërkua informacion pranë institucioneve përkatëse, si vijon:

<sup>10</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2023.

<sup>11</sup> Akt i vërtetuar nga noteri me nr. \*\*\* regj., në datën 7.10.2000.

<sup>12</sup> Bashkëlidhur deklaratës ndodhet dokumentacioni vijues: (1) certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 15.4.2013, për pasurinë me nr. \*\*\*, apartament me sip. 116.61 m<sup>2</sup>, në pronësi të A dhe V.N – bashkëlidhur kartela e pasurisë; (2) kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2013, me palë blerëse A e V.N dhe palë shitëse shoqërinë ndërtimore “S - M” sh.p.k., me çmim 4.044.000 lekë; (3) certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 11.2.2013, për apartamentin në emër të “S - M” sh.p.k. - bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe planimetria e apartamentit; (4) kontratë sipërmarrjeje datë 5.10.2000 për ndërtim apartamenti me sip. 126 m<sup>2</sup>, me palë porositëse A.N dhe sipërmarrës “S - M” sh.p.k. për vlerën e apartamentit 37.800 USD - bashkëlidhur planimetria e apartamentit; (5) kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.6.1993, me shitës NKB K dhe blerës A.N, V, L, S, S dhe M.N, për një apartament në K, në vlerën 18.371 lekë; (6) kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.4.2010, me palë shitëse A, V, L, S dhe S.N, të përfaqësuar nga P.H dhe blerës Xh.H, për shitjen e një apartamenti në qytetin e K, në vlerën 1.986.671 lekë.



- a) Drejtoria Vendore e ASHK-së Tiranë Veri<sup>13</sup> ka konfirmuar pasurinë apartament të regjistruar në bashkëpronësi të A dhe V.N në datën 15.4.2013. Bashkëlidhur shkresës ndodhet dokumentacioni<sup>14</sup> përkatës i pronësisë.
- b) FSHU-ja<sup>15</sup> ka informuar se me gjeneralitetet A.M.N identifikohet një abonent në instancën Tiranë. Nga të dhënat e dërguara të sistemit të faturimit të FSHU-së evidentohet adresa e pasurisë tek rruga “K.G”, Tiranë, ku pagesat për konsumin e energjisë elektrike fillojnë nga janari i vitit 2007.
- c) UKT-ja<sup>16</sup> ka informuar se nuk rezultojnë të dhëna për kontrata të lidhura me shërbime Ujësjellës-Kanalizime Tiranë me shtetasen Laureta Nezaj, si dhe personat e lidhur me të.

### **Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ**

27.2 Nga aktet në dosje ka rezultuar se apartamenti është blerë nga babai i subjektit, z. A. N, me kontratën e sipërmarrjes datë 5.10.2000<sup>17</sup>, të lidhur me shoqërinë sipërmarrëse “S-M” sh.p.k., ku objekt i kësaj kontrate është ndërtimi i një apartamenti me sip. 126 m<sup>2</sup>, në kompleksin e banimit rruga “K.G”, Tiranë, sipas lejes së ndërtimit nr. \*\*, datë 23.7.1999, në vlerën 37.800 USD (300 USD/m<sup>2</sup>). Në vijim është nënshkruar kontrata e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2013, midis prindërve të subjektit dhe shoqërisë ndërtuese “S - M” sh.p.k., me administratore znj. N.H, kundrejt çmimit 4.044.000 lekë. Në kontratën e shitjes përcaktohet se kjo vlerë është likuiduar nga ana e blerësve jashtë zyrës noteriale, sipas kontratës së sipërmarrjes.

27.3 Në përmbajtje të kontratës së sipërmarrjes datë 5.10.2000 përcaktohet se pagesa do të kryhej pranë arkës së firmës, ku 30% e kontratës në dollarë do të paguhej me lidhjen e kontratës; me mbarimin e punimeve që parashikon kjo kontratë do të bëhej pagesa 90% në dollarë dhe pjesa që mbetet, 10%, në dollarë, do të paguhej kur të mbronin komplet punimet.

27.4 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar<sup>18</sup> se pagesa për blerjen e apartamentit është dakordësuar dhe kryer në favor të shoqërisë ndërtuese në vitet 2000 – 2001, kohë në të cilën është lidhur kontrata e sipërmarrjes mes babait të ndjerë dhe shoqërisë ndërtuese, dhe regjistrimi i të gjithë pallatit nga ana e firmës ka përfunduar në vitin 2013, për shkak të procedurave të legalizimit të kateve shtesë, tej lejes së ndërtimit nga ana e shoqërisë ndërtuese, për rrjedhojë formalisht shitblerja e apartamentit është bërë në vitin 2013.

27.5 Komisioni ka kërkuar informacion pranë shoqërisë ndërtuese “S - M” sh.p.k. lidhur me pagesat e kryera për blerjen e këtij apartamenti, ku kjo shoqëri ka informuar<sup>19</sup> se në vitin 2000 ka ndërtuar një godinë banimi 4, 6, 8, 10, 12 kate në rrugën “K.G”, Tiranë, dhe në këtë godinë blerësit A dhe V.N kanë blerë apartamentin me sipërfaqe të përgjithshme 126 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 37.800 USD, e konvertuar në lekë 4.044.000 lekë. Shoqëria ndërtuese ka informuar se, duke qenë se nga momenti i kryerjes së pagesave nga blerësi me anë të kontratës së porosisë të lidhur midis palëve ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, prej 24 vitesh, në

<sup>13</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2023.

<sup>14</sup> Kartela e pasurisë së paluajtshme me nr. \*\*\*, e lëshuar në datën 20.6.2023; aplikim nr. \*\*\*, datë 4.4.2013; tri mandate bankare të Credins Bank, datë 4.4.2013, për pagesën e shumës 6.150 lekë, shuma 3.498 lekë dhe shuma 113.252 lekë; kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2013; certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, e lëshuar në datën 11.2.2013, për pasurinë apartament me sip. 116.61 m<sup>2</sup> në emër të “S- M” sh.p.k.; kartela e pasurisë (1 faqe); planimetria e apartamentit nr. \*; certifikatë familjare datë 28.2.2013; ekstrakt i regjistrimit tregtar i QKB-së për shoqërinë “S- M” sh.p.k.

<sup>15</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2023.

<sup>16</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2023.

<sup>17</sup> Akt i vërtetuar nga noteri me nr. regj\*\*\*, në datën 7.10.2000.

<sup>18</sup> Shpjegimet e subjektit me email datë 8.1.2024, në përgjigje të pyetësorit datë 18.12.2023.

<sup>19</sup> Me shkresën nr. \*\* prot., datë 10.1.2024, regjistruar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2024.

funksion të ligjit për kontabilitetin dhe tatimet nuk i kanë më të ruajtura dokumentet e asaj periudhe. Nga arkivi i shoqërisë kanë në dispozicion vetëm kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 2.4.2013, të cilën e kanë vendosur në dispozicion të Komisionit.

27.6 Lidhur me periudhën e përfundimit të ndërtimit dhe fillimit të banimit në apartament, gjatë hetimit subjekti ka shpjeguar<sup>20</sup> se ndërtimi i pallatit është kryer në disa faza, ku fillimisht ka nisur dhe përfunduar pjesa 4-katëshe, e cila është bërë e banueshme në fund të shtatorit të vitit 2001, kur është bërë edhe instalimi i energjisë elektrike dhe ujit. Subjekti ka sqaruar se ajo dhe familja e saj kanë filluar të banojnë aty që nga tetori i vitit 2001, ndërkohë që pjesa tjetër e pallatit (seksioni tjetër, pasi është në formë L-je) vazhdonte ndërtimin. Subjekti ka depozituar<sup>21</sup> si dokument provues vërtetimin nr. \*\* prot., datë 4.1.2024, të lëshuar nga Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Nr. \*, e cila konfirmon se z. A.N është vendosur pranë kësaj njësie bashkiake nga data 13.12.2001 deri aktualisht.

### **Burimi i krijimit**

27.7 Në deklaratën *Vetting*, babai A.N, duke qenë në cilësinë e personit të lidhur me subjektin, në kuptim të pikës 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie: (i) kursimet e tij dhe bashkëshortes ndër vite; (ii) shitjen e apartamentit në Kukës.

27.8 Komisioni i ka kërkuar<sup>22</sup> subjektit të sqarojë dhe dokumentojë në mënyrë shteruese burimin e ligjshëm të krijimit të apartamentit dhe periudhën në të cilën janë krijuar kursimet familjare të prindërve, deri në momentin e blerjes, për të cilën subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar<sup>23</sup> se blerja e këtij apartamenti është realizuar nga prindërit me të ardhurat nga shitja e apartamentit në pronësi të tyre në Kukës, në vitin 2001, por dokumentacioni është bërë më vonë në kohë, duke qenë se është shitur tek një i afërm dhe pjesa tjetër nga kursimet familjare të prindërve deri në momentin e blerjes së apartamentit.

27.9 Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në këtë kohë ajo dhe vëllezërit e saj nuk ishin në marrëdhënie pune, pasi subjekti ka qenë studente në universitet dhe motra e vëllezërit në proces shkollimi e, për rrjedhojë, nuk kanë pasur asnjë kontribut në krijimin e kësaj pasurie. Subjekti ka saktësuar se gjatë gjithë periudhës, nga viti 2001 deri në datën 6.5.2021 kur është martuar, ka qenë përdoruese vetëm e apartamentit në pronësi të prindërve dhe, pas ndarjes nga jeta të babait, ajo së bashku me vëllezërit e motrën kanë hequr dorë nga trashëgimia ligjore përmes deklaratës noteriale<sup>24</sup> të datës 15.6.2023, duke sqaruar se aktualisht pronare e vetme e kësaj pasurie është nëna e saj V.N, bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 15.6.2023, të cilën e ka vendosur në dispozicion të Komisionit.

27.10 Komisioni ka analizuar burimet e ligjshme të të ardhurave të deklaruara, të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, si vijon:

#### **a) Lidhur me kursimet e prindërve të subjektit të rivlerësimit ndër vite**

<sup>20</sup> Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 21.2.2024.

<sup>21</sup> Dokument i depozituar në datën 8.1.2024.

<sup>22</sup> Përmes pyetësorit me *email*, datë 18.12.2023

<sup>23</sup> Shpjegimet e subjektit të depozituara me nr. \*\*prot., datë 8.1.2024.

<sup>24</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.6.2023, e nënshkruar nga subjekti dhe vëllezërit S.N, S.N, M.N, e depozituar nga subjekti në datën 8.1.2024.

27.11 Me informacionin e ardhur nga ISSH-ja<sup>25</sup> konfirmohen të ardhurat nga pensioni i babait A.N nga mars 2000 e në vijim, ndërsa nëna e subjektit V.N përfiton pension pleqërie nga shtatori 2012.

27.12 Komisioni i ka kërkuar<sup>26</sup> subjektit të depozitohet dokumentacion i justifikues ligjor mbi çdo të ardhur të realizuar nga prindërit në cilësinë e personave të lidhur, deri në momentin e blerjes së apartamentit. Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion i justifikues ligjor mbi të ardhurat e prindërve, përveç librezave të pensionit të prindërve (1 faqe), si dhe vërtetimet<sup>27</sup> e punësimit të saj dhe vëllëzërve, dokumentacion i cili ishte i njëjtë me ato të depozituara në deklaratën *Vetting*.

27.13 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar<sup>28</sup> se të dy prindërit kanë punuar nga mosha 14 vjeç dhe në vazhdim, nëna deri në vitin 1992, dokumentacion i cili është dorëzuar pranë DRSSH-së Tiranë për lidhjen e pensionit përkatës, ndërsa babai nga mosha 14 vjeç deri në vitin 1992, kur është mbyllur Parku Automobilistik i Mallrave, ka punuar si gjenerik (kategoria 7), dokumentacion i depozituar pranë DRSSH-së për lidhjen e pensionit dhe për periudhën pas mbylljes së Parkut ka punuar më vete, po në profesionin e tij, në mënyrë informale.

27.14 Nga hetimi i kryer u evidentua mungesë dokumentacioni i justifikues ligjor mbi të ardhurat e prindërve për periudhën deri në momentin e blerjes së apartamentit, në vitin 2000.

#### **b) Lidhur me shitjen e pasurisë së paluajtshme në Kukës**

27.15 Nga aktet në dosje ka rezultuar se përmes kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.4.2010, prindërit, subjekti dhe vëllëzërit e saj, të përfaqësuar me prokurë<sup>29</sup> nga shtetasi P.H, i kanë shitur shtetasit Xh.H një apartament<sup>30</sup> me sip. 83.4 m<sup>2</sup>, në Kukës, në vlerën 1.986.671 lekë, të likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

27.16 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar<sup>31</sup> ndër të tjera se shitja e apartamentit në Kukës është kryer që në vitin 2001, por dokumentacioni është bërë më vonë në kohë, duke qenë se është shitur tek një i afërm.

<sup>25</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2023.

<sup>26</sup> Përmes pyetësorit me *email* datë 18.12.2023 dhe pyetësorit me *email* datë 13.2.2024.

<sup>27</sup> Dokumentacioni i depozituar në datën 8.1.2024: kopje e librezës së pensionit nr. \*\*\* të babait A.N (1 faqe); kopje e librezës së pensionit të nënës V.P (N) me nr. \*\*\* (1 faqe), ku pagesat fillojnë nga data 1.10.2012 me masë pensioni 7.887 lekë; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2017, e lëshuar nga Gjykata e Lartë, e cila konfirmon të ardhurat nga paga e subjektit për periudhën qershor 2013 – dhjetor 2016; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2016, e lëshuar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, e cila konfirmon të ardhurat nga paga të subjektit për periudhën 2008 – 2013; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2016, i lëshuar nga Avokatura e Shtetit, shoqëruar me listëpagesat e viteve, e cila konfirmon të ardhurat nga paga të S.N (motra) për periudhën 26.2.2014 – 30.9.2016; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017, i lëshuar nga Avokatura e Shtetit, e cila konfirmon të ardhurat nga paga të S.N (motra) për periudhën 1.10.2016 – 31.12.2016; vërtetim i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë nr. prot. (s'ka), datë 13.1.2017, e cila konfirmon se shtetasi S.N (vëllai) nuk është i regjistruar në DRT-në Tiranë; vërtetim datë 12.1.2016 i lëshuar nga shoqëria "MPM \*\*\*" sh.p.k., e cila konfirmon punësimin e shtetasit M.N (vëllai) nga data 29.11.2016, me pagë bruto 30.000 lekë; vërtetim datë 11.1.2017 i lëshuar nga shoqëria "C" sh.p.k., e cila konfirmon punësimin e shtetasit M.N në periudha të ndryshme gjatë vitit 2016, si dhe të ardhurat nga paga për periudhën qershor - dhjetor 2016; vërtetim pune i lëshuar në datën 10.1.2017 nga subjekti tregtar "A.P", i cili konfirmon punësimin e shtetasit M.N si kamerier dhe të ardhurat e pagës për periudhën 5.10.2015 – 1.6.2016.

<sup>28</sup> Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 21.2.2024.

<sup>29</sup> Prokura e posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.3.2010, e lëshuar nga A.N dhe V.N, si dhe prokura e posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.4.2010, e lëshuar nga Laureta Nezaj, S.N dhe S.N.

<sup>30</sup> Kjo pasuri është blerë nga prindërit e subjektit përmes privatizimit të banesave shtetërore me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.6.1993, në vlerën 18.371 lekë, ku subjekti Laureta Nezaj, si dhe vëllëzërit e saj S.N, S.N dhe M.N (në akte përmendet mbiemri N dhe jo N) janë gjithashtu bashkëpronarë të kësaj pasurie, si anëtarë madhorë të familjes, në kuptim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore".

<sup>31</sup> Shpjegimet e subjektit të depozituara me nr. \*\* prot., datë 8.1.2024.

27.17 Referuar aktit ligjor, kontratës së shitblerjes datë 8.4.2010, dokumentohet shitja e apartamentit në vitin 2010 dhe të ardhurat nga shitja e saj nuk mund të jenë përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 2000.

### **Analiza financiare**

27.18 Referuar fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi, si trajtuar më sipër, në kushtet kur nuk u administrua asnjë e dhënë në lidhje me mundësitë financiare të prindërve të subjektit përpara blerjes së apartamentit (përpara vitit 2000), Komisioni ndodhej në pamundësi për kryerjen e një analize financiare për këtë pasuri.

### **Konstatime të Komisionit**

27.19 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se:

- Apartamenti është blerë nga babai i subjektit në vitin 2000, shumë kohë para emërimit të subjektit në detyrën e ndihmëses ligjore.
- Ka pasaktësi në deklaram lidhur me burimin që ka shërbyer për blerjen e apartamentit nga babai, pasi referuar aktit ligjor shitja e pasurisë në Kukës është kryer shumë kohë më vonë, në vitin 2010 dhe të ardhurat nga shitja e saj në vlerën 1.986.671 lekë nuk mund të jenë përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 2000.
- Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor mbi të ardhurat e prindërve për periudhën deri në momentin e blerjes së apartamentit, në vitin 2000.

✓ Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime, si dhe dokumentacion mbi të ardhurat e ligjshme të prindërve, të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

27.20 Në lidhje me apartamentin në pronësi të prindërve, subjekti përmes prapësimeve të saj ka parashtruar se, siç është sqaruar në përgjigjet e pyetësorëve, janë të ardhura të realizuara nga prindërit deri në momentin e blerjes së apartamentit.

27.21 Në lidhje me konstatimin e Komisionit se të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kukës, në vitin 2010, nuk mund të jenë përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, në vitin 2000, subjekti ka depozituar një deklaratë të shtetasit z. Xh.H, i cili deklaroi se në vitin 2001 ka blerë nga shtetasi A.N një apartament me sip. 83.4 m<sup>2</sup>, në Lagjen Nr. \*, Kukës. Ky shtetas deklaroi se, duke qenë se kishin lidhje krushqie me njëri-tjetrin (pasi bashkëshortet janë kushërira), me dakordësinë e të dyja palëve kanë vepruar me shitje faktike, duke iu vendosur në dispozicion apartamenti dhe pagesa e vlerës së apartamentit që në atë vit dhe më pas kanë vepruar me kalimin e pronësisë dhe regjistrimin e pronës në emrin e tij pranë ZVRPP-së Kukës në vitin 2010.

### **Vlerësimi i Komisionit**

27.22 Trupi gjykues, pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton se subjekti nuk provoi me dokumentacion të ardhurat e ligjshme të prindërve për blerjen e apartamentit në Tiranë, në vitin 2000.

27.23 Nga një vlerësim tërësor i situatës faktiko-ligjore, nisur nga faktet e rezultuara gjatë hetimit se: (i) apartamenti është blerë nga prindërit në vitin 2000, shumë kohë përpara emërimit në detyrë të subjektit në qershor 2013; (ii) në deklaratën *Vetting* subjekti e ka

deklaruar këtë apartament si pasuri në përdorim; (iii) nga hetimi administrativ nuk u provua përfshirja e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e subjektit në krijimin e kësaj pasurie dhe nuk ngrihen dyshime për pasuri të fshehur të subjektit, Komisioni çmon se mungesa e dokumentacionit, i konstatuar pa lidhje në çfarëdolloj forme me subjektin e rivlerësimit, nuk impakton pozitën e saj dhe, si e tillë, nuk mund të barazohet me detyrimin që vetë subjekti/et kanë sipas ligjit nr. 84/2016.

27.24 Në përfundim lidhur me këtë çështje, pavarësisht se Komisioni kreu një hetim të plotë referuar dhe jurisprudencës së KPA-së<sup>32</sup>, për provueshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, për lidhje të mundshme të subjektit me të, duke qenë se përgjatë gjithë procesit për këtë subjekt nuk u evidentua ndonjë dyshim lidhur me burimin e krijimit ku të përfshihej subjekti i rivlerësimit apo për fshehje pasurie të subjektit të rivlerësimit, deklarim të rremë, si dhe në mungesë të çdo informacioni negativ nga organet ligjzbatuese për figurën e saj, çmon se nuk ka rrethana të tilla që afektojnë procesin e rivlerësimit të subjektit.

## **28. Të ardhurat<sup>33</sup> nga pensioni në shumën 14.785 lekë/muaj**

28.1 Nga të dhënat e dërguara nga ISSH-ja<sup>34</sup> konfirmohen të ardhurat e shtetasit A.N nga pensioni i pleqërisë nga marsi 2000 e në vijim.

✓ Deklarimi dhe dokumentacioni i paraqitur përputhen me përgjigjen e ISSH-së.

### **DEKLARIMI I PASURISË NGA NËNA E SUBJEKIT TË RIVLERËSIMIT**

**29. Apartament banimi** në bashkëpronësi me bashkëshortin, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*\*, me sip. 116.61 m<sup>2</sup>, në rrugën “K.G”, Tiranë, z. k. \*\*\*, fituar sipas kontratës së sipërmarrjes datë 5.10.2000. Pasuri e fituar nga kursimet ndër vite e bashkëshortit dhe shitja e apartamentit në Kukës. Vlera: 4.044.000 lekë. Zotërimi: ½ pjesë.

✓ Trajtuar më sipër.

## **30. Të ardhura nga pensioni<sup>35</sup> në shumën 10.400 lekë/muaj**

30.1 ISSH-ja<sup>36</sup> ka dërguar të dhëna mbi masën e pensionit të pleqërisë të përfituar nga znj. V. N, të cilat fillojnë nga shtatori 2012 e në vijim.

✓ Deklarimi dhe dokumentacioni i paraqitur përputhen me përgjigjen e ISSH-së.

### **DEKLARIMI I PASURISË NGA MOTRA DHE VËLLEZËRIT**

**31.** Në deklaratën *Vetting*, motra S.N dhe vëllezërit e subjektit, S dhe M.N, si persona të lidhur me subjektin, kanë deklaruar se banojnë me prindërit në apartamentin në rrugën “K.G”, Tiranë, në pronësi të tyre, sipas të dhënave në faqen përkatëse të personave të lidhur.

✓ Pasuri e trajtuar më sipër.

## **VERIFIKIME TË TJERA**

<sup>32</sup> Vendim nr.10 (JR) Datë 14.04.2022, pika 15.

<sup>33</sup> Bashkëlidhur deklaratës ndodhet librezë pensioni për shtetasin A. N (1 faqe).

<sup>34</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2023.

<sup>35</sup> Bashkëlidhur deklaratës ndodhet librezë pensioni për shtetasen V.N (1 faqe).

<sup>36</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2023.

## 32. Komisioni verifikoi llogaritë bankare të subjektit dhe personave të lidhur

32.1 Nga hetimi i kryer ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur llogari bankare në banka të ndryshme<sup>37</sup>, ku gjendja e likuiditeteve në këto llogari bankare (kryesisht llogari page/rrjedhëse ose kursimi) nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting*.

### Konstatim i Komisionit

32.2 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe as në deklaratimet periodike vjetore gjendjen e likuiditeteve në llogaritë e saj bankare, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 4, pika d e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

✓ Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime.

### Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

32.3 Në lidhje me llogaritë bankare, subjekti ka shpjeguar se këto llogari janë llogari page, të ardhura të cilat janë deklaruar prej saj si subjekt në deklaratat periodike vjetore pranë ILDKPKI-së (ndërkohë që për familjarët, konkretisht për motrën dhe vëllain, që rezultojnë me llogari bankare, ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*).

32.4 Sipas shpjegimeve të subjektit, motra dhe vëllai rezultojnë me disa llogari page, pasi në personat fizikë apo juridikë privatë ku kanë punuar, paga derdhej prej tyre në bankën në të cilën subjektet punëdhënës kryenin transaksionet e tyre financiare. Vlerat në llogarinë e subjektit kanë qenë diferenca të vogla mes vlerës së pagës së tërhequr dhe asaj të mbetur. Sipas shpjegimeve të subjektit, nisur nga fakti që në këto llogari derdhet paga nga institucioni punëdhënës për subjektin dhe motrën (të dyja institucione shtetërore) dhe vëllai nga një subjekt privat, të cilat janë të verifikueshme lehtësisht në çdo moment dhe të ardhurat vjetore përkatëse janë deklaruar në deklaratën *Vetting* për të gjithë anëtarët e familjes dhe deklaratimet periodike për subjektin e rivlerësimit (pasur parasysh edhe vlerat e mbetura në llogari), e ka konsideruar të përmbushur si detyrim për deklarimin e të ardhurave.

### Vlerësimi i Komisionit

32.5 Trupi gjykues i çmon bindëse shpjegimet e subjektit, nisur edhe nga fakti se nga hetimi i Komisionit nuk kanë rezultuar problematika lidhur me të dhënat e llogarive bankare, megjithëse subjekti duhej të deklaronte gjendjet e këtyre likuiditeteve në deklaratimet periodike vjetore, si dhe në deklaratën *Vetting*, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

## 33. Komisioni verifikoi të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS<sup>38</sup> në lidhje me udhëtimet e kryera nga subjekti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ku nga hetimi i kryer ka

<sup>37</sup> (1) Raiffeisen Bank me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2023, ka konfirmuar disa llogari bankare në emër të subjektit dhe personave të lidhur, ku nga të dhënat bankare kanë rezultuar, ndër të tjera: (a) llogari page në lek, në emër të subjektit Laureta Nezaj, e çelur në 22.10.2008, me gjendje aktuale 849.942 lekë; (b) llogari page në emër të motrës S.N, e çelur në datën 19.9.2016, me gjendje aktuale 949.467 lekë; (c) një llogari rrjedhëse në emër të vëllait M.N, e çelur më 6.6.2016 dhe mbyllur në datën 11.12.2018; (2) BKT-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2023, ka konfirmuar një llogari page në emër të shtetasit M.N (vëllai i subjektit), e çelur në datën 12.10.2015; (3) Fibank me shkresën nr. ON-A-\*\*\* prot., datë 9.5.2023, ka konfirmuar se shtetasi M.N ka dy llogari pranë bankës, një llogari kursimi, e cila aktualisht është e mbyllur, si dhe një llogari page aktive. Nga të dhënat bankare evidentohet se llogaria e kursimit është çelur më 8.5.2015 dhe mbyllur në datën 9.2.2017, si dhe llogaria e pagës e çelur në dhjetor 2016; (4) Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2023, ka informuar se shtetasja S.N ka pasur dy llogari pranë bankës. Nga të dhënat e historikut të llogarisë evidentohet një llogari rrjedhëse dhe një llogari kursimi në lek, të çelura në dhjetor 2011 dhe mbyllur më 3.11.2017.

<sup>38</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

rezultuar se shpjegimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e përcjellë nga sistemi TIMS.

**Tabela e përgjithshme e analizës financiare për periudhën 2013 – 2016**

<i>PERSHKRIMI</i>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>PASURI</b>	<b>8 667</b>	<b>691 243</b>	<b>700 393</b>	<b>134 162</b>
Apartament rr. Karl Gega 116.61 m2				
<i>Shtesa/Pakesime likuiditete</i>	<i>8 667</i>	<i>691 243</i>	<i>700 393</i>	<i>134 162</i>
Likuiditete Gjendje	8 637	699 880	1 400 273	1 534 436
Gjendje cash	-	700 000	1 400 000	1 400 000
<b>DETYRIME</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>8 667</b>	<b>691 243</b>	<b>700 393</b>	<b>134 162</b>
<b>TE ARDHURA</b>	<b>970 207</b>	<b>1 963 030</b>	<b>1 893 573</b>	<b>1 852 402</b>
Te ardhura nga paga e subjektit	933 009	1 247 588	1 022 449	957 735
Te ardhura nga pagat e familjes	37 198	715 442	871 124	894 667
<b>SHPENZIME</b>	<b>846 144</b>	<b>1 329 095</b>	<b>1 677 780</b>	<b>1 436 253</b>
Shpenzime jetese	846 144	1 319 988	1 345 656	1 410 552
Shpenzime udhëtimi TIMS		9 107	118 284	25 701
Shpenzime për sigurimin vullnetar			213 840	
<b>REZULTATI</b>	<b>115 396</b>	<b>-57 308</b>	<b>-484 600</b>	<b>281 987</b>

#### 34. Vlerësimi përfundimtar i kriterit të pasurisë

34.1 Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se subjekti ka deklaruar saktë pasuritë në deklaratën *Vetting* dhe nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë.

34.2 Komisioni, duke vlerësuar në tërësi çështjen së bashku me pasuritë e personave të lidhur, për një vlerësim sa më objektiv, duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara sa më sipër, vlerëson se balanca negative e rezultuar nga analiza financiare për vitet 2014 dhe 2015, në vlerën totale 541.908 lekë, si dhe pasaktësitë në deklarinimin e babait si person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, në lidhje me burimet e ligjshme për blerjen e apartamentit, nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të çuar subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

#### B. KONTROLLI I FIGURËS

35. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

36. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, AKSIK-ja ka dërguar një raport<sup>39</sup> në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të znj. Laureta Nezaj.

#### **Vlerësimi i Komisionit për kontrollin e figurës**

37. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

38. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit znj. Laureta Nezaj ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, dhe ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

#### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

39. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit<sup>40</sup> të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

40. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- i) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- ii) 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

##### **i. Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit**

41. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit konstatohet se formulari është plotësuar në mënyrë të plotë, pa mangësi nga pikëpamja formale. Subjekti ka deklaruar të dhënat për periudhën nga mars 2004 – qershor 2013 e deri aktualisht.

##### **ii. Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

42. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 3 relacione, ku njëri i përket vitit 2015, i dyti vitit 2016 dhe i treti jashtë periudhës së rivlerësimit, pasi, bazuar në vendimet gjyqësore përfundimtare, nuk rezulton i pasqyruar në tabelat statistikore të Gjykatës së Lartë. Këto tri relacione të përpiluara prej saj analizohen si më poshtë:

<sup>39</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, i AKSIK-së, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.5.2023, të KDZH-së.

<sup>40</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 25.4.2023, i KLGJ-së.



**43. Dokumenti 1** – Relacion për çështjen administrative nr. \*\*\* akti, me palë ndërgjyqëse: paditës B.Gj, e paditur ZVRPP Vlorë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me objekt “Kundërshtimin e pjesshëm të vendimit nr. \*\*\*, datë 29.4.2010, të kryeregjistruesit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme anulimin e pikës 2 të këtij vendimi; detyrimin e ZVRPP-së Vlorë të pajisë me certifikatë pronësie paditësin, duke përcaktuar sipërfaqen e pronës së tij prej 3.890 m<sup>2</sup>”.

43.1 Në fund të relacionit konstatohet se nuk jepet një konkluzion lidhur me fatin e rekursit, por nisur nga qëndrimi ndaj vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë për pranimin e padisë dhe vendimmarrja e gjykatës së apelit për lënien në fuqi të shkallës së parë, kuptohet konkluzioni i ndihmëses Nezaj, se rekursi i paraqitur nga pala e paditur nuk duhet të pranohet. Mosparaqitja e vendimit të Gjykatës së Lartë bën të pamundur nxjerrjen e konkluzionit nëse mendimi i ndihmësit ligjor në këtë rast përputhet apo jo me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë.

**44. Dokumenti 2** – Relacion për çështjen administrative me nr. \*\*\* akti, datë 4.9.2014, me palë ndërgjyqëse paditës Z.F, të paditur ZVRPP-në Lezhë dhe person i tretë Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me objekt “Shfuqizimin e urdhrin datë 12.1.2006, të dhënë nga ZVRPP Lezhë; detyrimin për regjistrimin e kontratës së shitblerjes tokë pemëtoare dhe ndërtesë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.3.2005”.

44.1 Konstatohet se në fund të relacionit nuk jepet një konkluzion lidhur me fatin e rekursit, por nisur nga qëndrimi i ndihmëses mund të kuptohet konkluzioni i ndihmëses Nezaj, se rekursi i paraqitur nga pala e paditur duhet të pranohet. Mosparaqitja e vendimit të Gjykatës së Lartë bën të pamundur nxjerrjen e konkluzionit nëse mendimi i ndihmësit ligjor në këtë rast përputhet apo jo me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë.

**45. Dokumenti 3** – Relacion për çështjen administrative me nr. \*\*\* akti, datë 20.5.2015, me palë ndërgjyqëse kërkues prefektin e qarkut Fier, person i tretë B.I e komuna F, me objekt “Deklarimin e pavlefshmërisë së pjesshme të aktit të marrjes së tokës në pronësi me nr. \*\*\* akti, për pasurinë nr. \*\*\*, në emër të fermerit B.I; shfuqizimin e tij dhe kthimin e tokës në gjendjen e mëparshme, në tokë shtet”.

45.1 Në këtë relacion është argumentuar nga ndihmësja se përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, sepse gjykata që shqyrton mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet, të kryejë një hetim të plotë e të gjithanshëm, në përputhje me ligjin dhe të zgjidhë mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi. Mosparaqitja e vendimit të Gjykatës së Lartë bën të pamundur nxjerrjen e konkluzionit nëse mendimi i ndihmësit ligjor në këtë rast përputhet apo jo me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë.

#### **Konstatime të Komisionit**

**46.** Nga analizimi i të tria dokumenteve ligjore konstatohet se në fund të relacioneve të hartuara nga subjekti nuk jepet një konkluzion lidhur me fatin e rekursit, pa propozim për zgjidhjen konkrete të çështjeve dhe nuk evidentohet nëse vendimmarrjet e Gjykatës së Lartë janë të njëjta me mendimin e ndihmësit ligjor.

✓ Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime, si dhe të depozitohë dokumentacion mbështetës.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

47. Në lidhje me tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ku është konstatuar se në fund të relacioneve nuk jepet një konkluzion lidhur me fatin e rekursit, subjekti ka shpjeguar se në praktikën e punës nga ana e këshilltarit ligjor propozohet mospranimi i rekursit ose kalimi i çështjes në seancë gjyqësore, duke u evidentuar problematikat ligjore të konstatuara.
48. Në lidhje me propozimin konkret për zgjidhjen e çështjes, subjekti ka shpjeguar se vetëm në vitin 2023 nga ana e Këshillit të Gjykatës u miratua një format relacioni që duhet t'i përmbahej e gjithë njësisia ligjore sipas kolegjeve përkatëse. Subjekti ka paraqitur një *email* të datës 4.7.2023, sipas të cilit është dërguar formati i relacionit që duhet të përgatisin këshilltarët ligjorë (sipas kompetencës së kolegjit përkatës), i miratuar me vendim nga Këshilli i Gjykatës së Lartë.
49. Në prapësime, subjekti ka parashtuar edhe vendimmarrjet e Gjykatës së Lartë për çështjet që u përkasin tri relacioneve të paraqitura prej saj, si dhe ka depozituar vendimet gjyqësore<sup>41</sup> përkatëse, konkretisht: (i) Për dokumentin 1, subjekti ka depozituar vendimin nr. \*\*\* (\*\*), datë 10.3.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. \*\*\*, datë 5.6.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë (ku rezulton që relatori dhe një gjyqtar tjetër janë në pakicë); (ii) Për dokumentin 2, subjekti ka depozituar vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 8.6.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit është vendosur prishja e vendimit nr. \*\*\*, datë 19.5.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues; (iii) Për dokumentin 3, subjekti ka depozituar vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*), datë 16.11.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit është vendosur prishja e vendimit nr. \*\*\*, datë 31.3.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe vendimit nr. \*\*\* (\*\*), datë 20.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

### **Vlerësimi i Komisionit**

50. Komisioni vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti në prapësime, duke i konsideruar ato bindëse. Lidhur me vendimmarrjet e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për çështjet që u përkasin tri relacioneve të paraqitura nga subjekti, Komisioni ka evidentuar se këto vendime nuk vijnë në kundërshtim me propozimet e ndihmësës ligjore.

### **iii. Përshkrimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short**

51. Nga shorti i hedhur u përzgjedhën 5 dosje, të cilat u vunë në dispozicion nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Tiranë, Durrës, si dhe Gjykatës së Lartë, të cilat u analizuan nga Komisioni.
52. Nga hetimi i Komisionit për 5 dosjet e vëzhguara u evidentua se në tri prej tyre mendimi i ndihmësës ligjore ishte i njëjtë me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, ndërsa për dy çështje argumentet në relacionin e ndihmësës ligjore nuk janë përdorur nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj, ku mendimi i ndihmësës nuk ishte i njëjtë me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë.

<sup>41</sup> Vendimi nr. 00-2015-\*\*\* (\*\*\*), datë 10.3.2015, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendimi nr. 00-2016-\*\*\* (\*\*\*), datë 8.6.2016, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendimi nr. 00-2016-\*\*\* (\*\*\*), datë 16.11.2016, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

✓ Komisioni nga dosjet e vëzhguara nuk gjeti *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

#### **iv. Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së**

53. Nga të dhënat e formularit të vetëvlerësimit konstatohet se subjekti i rivlerësimit Laureta Nezaj, nuk ka ushtruar asnjëherë funksionin e gjyqtarit pranë ndonjë gjykate të Shkallës së Parë apo të Apelit. Rrjedhimisht, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk disponohen të dhëna për veprimtarinë për këtë subjekt.

#### **v. Analiza e gjetjeve**

54. Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formulari i vetëvlerësimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dokumentet ligjore të vëzhguara të përzgjedhura me short.

##### **Aftësitë profesionale**

54.1 Subjekti i rivlerësimit znj. Laureta Nezaj ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën civile dhe administrative, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ajo ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë. Njohuritë e saj ligjore konfirmohen edhe nga angazhimet e saj ndër vite si dhe pjesëmarrja e saj në testimin profesional të subjekteve *ex officio* të organizuar në Shkollën e Magjistraturës.

##### **Aftësitë organizative**

54.2. Nga analizimi i dokumenteve të vëzhguara evidentohen tre faktorë: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar numrin e çështjeve për relativitet që i janë caktuar dhe, rrjedhimisht, rendimenti i punës së saj përcaktohet i plotë, për të përballuar ngarkesën në punë; (ii) kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës së Lartë; (iii) mungesa e të dhënave mbi kohën e caktimit të çështjeve për relativitet dhe e datës së përfundimit të relacionit nga ndihmësja ligjore bën të pamundur llogaritjen e kohëzgjatjes së secilit relacion të ndihmësës ligjore të përzgjedhur me short për vlerësim.

54.3 Nga dokumentet e vëzhguara konstatohet se në çdo rast ndihmësja ligjore ka studiuar çështjen gjyqësore dhe e ka relatuar për çdo shkallë gjykimi, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulëta, thelbin e analizës ligjore, si dhe shkaqet e rekursit. Këto veprime ajo i ka materializuar në relacionin ligjor, ku ka plotësuar elementet procedurale të kërkuara në nenin 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 25 të rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr. 214, datë 12.9.2014, të Kryetarit të kësaj Gjykate.

##### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

54.4 Në burimet arkivore të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk disponohen të dhëna mbi etikën e ndihmësës ligjore Laureta Nezaj. Por, me shkresën e kancelares në detyrë të Gjykatës së Lartë, me nr. \*\*\* prot, datë 9.3.2023, është konfirmuar se për subjektin e rivlerësimit përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

54.5 Nga dokumentet dhe relacionet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo

elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit. Gjithashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

54.6 Në dokumentet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është në përputhje me etikën gjyqësore, e qartë, e plotë dhe e saktë. Nuk janë konstatuar vonesa në relatimin e çështjes që të kenë sjellë problematika në gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi apo në seancë gjyqësore.

54.7 Znj. Nezaj ka deklaruar se detyra e saj konsiston në veprimtari ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë, duke përfshirë: përgatitjen e relacioneve për në dhomë këshillimi, përgatitjen e projektvendimeve për çështje gjyqësore civile dhe administrative, studimin e kërkesave dhe përfundimin e projektvendimeve për pezullim të ekzekutimit të vendimeve civile dhe administrative.

### **DENONCIME**

55. Nga verifikimi i kryer, në regjistrin e denoncimeve nuk rezultojnë denoncime të regjistruara për subjektin e rivlerësimit Laureta Nezaj.

### **Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

56. Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e ndihmëses ligjore Laureta Nezaj dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efektive dhe eficiente në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “e aftë”.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Laureta Nezaj (Çaushi) ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Laureta Nezaj (Çaushi), me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë.

2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 3.4.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**

**Kryesues**

**Suela ZHEGU**

**Relatore**

**Brunilda BEKTESHI**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*

*Etmonda Hoxha*